



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KRYEMINISTRIA**  
**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

Nr. Prot. 3643

Tiranë, më 30.06.2017

**LËNDA:** Kërkesë për informacion

**DREJTUAR:** Znj. Albana KOÇIU  
Drejtor i Departamentit të Administratës Publike

E nderuar Znj. Koçiu,

Në kuadër të detyrave të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave në VKM nr. 473, datë 01.06.2017 për procesin zgjedhor, lutemi të na dërgoni një informacion të përditësuar lidhur me:

1. rastet e nëpunësve civilë të cilët janë pezulluar pasi kanë qenë kandidat për deputet në zgjedhjet për Kuvend dhe sa nga këto raste pezullimi janë bërë me kërkesë të vetë kandidatit dhe sa kryesisht nga institucioni juaj apo institucione të tjera të administratës;
2. rastet e procedimeve disiplinore të referuara pranë DAP për shkelje të lidhura me zgjedhjet, statusi i procedimit dhe masat disiplinore që janë marrë deri më sot (nëse ka).

Lutemi një përgjigje sa më shpejt të jetë e mundur.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**LEDINA MANDIJA**

